

Te nderuar,

2602
13/1

Në përgjigje të kërkesës suaj, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me nr. 342 prot., datë 05.03.2025, bashkëlidhur në *e-mail* gjeni vendimet me arsyetim të përmbledhur, të anonimizuar:

- Vendimin nr. 9 (JR), datë 28.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me kërkesues Artan Bajrami, si dhe
- Vendimin nr. 10 (JR), datë 28.02.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me kërkesues Bilbil Mete.

Faleminderit!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 1-20/2019 regjistër (JR)
Datë 07.01.2022



Nr. 9 i vendimit
Datë 28.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.02.2025, ditën e premte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen që i përket:

KËRKUES: Artan Bajrami, banues në rrugën “ ”, Njësia Bashkiake nr. , Tiranë.

OBJEKTI:

1. Rishikimi i Vendimit nr. 11 (JR), datë 03.07.2020 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili është marrë në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përmes të cilit kërkuesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
2. Prishjen tërësisht të Vendimit nr. 11 (JR), datë 03.07.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe gjykimin e çështjes në themel.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4 pika 1, 5, 6, 7, 15, 42, 116, pika 1, 122, 124 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Nenet 494-498/a të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,


pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkesit në kërkesën e paraqitur prej tij dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 11 (JR), datë 03.07.2020, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR:

1. Kërkuesi Artan Bajrami, (në vijim kërkuesi), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (në vijim "ligji nr. 84/2016"). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), me vendimin nr. 107, datë 14.02.2019 vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Këtë vendim, kërkuesi e ankmoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji"), i cili me vendimin nr. 11/2020 (JR), datë 03.07.2020, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 107, datë 14.02.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Në kërkesën për rishikimin e vendimit të Kolegjit [që mban nr. 11 (JR), datë 03.07.2020], kërkuesi parashtron në mënyrë të përmbledhur:

2.1. Gjykimi dhe dhënia e vendimit objekt rishikimi është realizuar nga një trupë gjyqësore, ku njëri prej anëtarëve të saj, konkretisht gjyqtari L D , nuk plotësonte kushtet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, për të ushtruar detyrën e gjyqtarit. Gjithashtu kërkuesi shpjegon se emërimi i L D në detyrën e gjyqtarit të Kolegjit nga organi kompetent nuk ishte pasojë e një vlerësimi të gabuar, por për shkak të veprave penale të kryera me faj prej tij. Organi kompetent emëroi L D si gjyqtar në Kolegj, për shkak se ai i paraqiti këtij organi dokumente të falsifikuara si dhe fshehu informacione të rëndësishme, të cilat çuan në emërimin e tij si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2.2. Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë të Kolegjit, bazohet në nenin 494, germa "c" e Kodit të Procedurës Civile dhe mbështetet në argumentet se jo vetëm është cenuar procesi i rregullt ligjor në rastin e tij, pasi gjyqtari nuk ka plotësuar kushtet ligjore për të



ushtuar detyrën, por edhe sepse pjesëmarrja e tij në këtë vendimmarrje ka qenë e kushtëzuar nga kryerja e një vepre penale. Ajo që është më e rëndësishme, kjo veprimtari kriminale ka përcaktuar emërimin e tij si gjyqtar dhe ka ndikuar në dhënien e vendimit të kësaj trupe gjyqësore, në dëm të interesave themelore kushtetuese.

2.3. Kërkuesi thekson gjithashtu se vendimi nr. 11 (JR), datë 03.07.2020, i Kolegjit, është dhënë me shumicë votash nga tre anëtarë (përfshirë L D), ndërsa dy anëtarë të tjerë janë shprehur kundër kësaj vendimmarrjeje. Për këto arsye, qenia pjesë e shumicës në vendimmarrje të ish gjyqtarit L D , në rastin konkret ka qenë vendimtare në dhënien e vendimit të atakuar nga kërkuesi.

3. Trupi gjykues në funksion të shqyrtimit të kërkesës me objekt rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, verifikoi aspektet formale të kërkesës për rishikim, duke e fokusuar analizën e tij në sa rezulton nga kuadri ligjor për sa i përket juridiksionit rishikues të Kolegjit, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në vijim të kësaj analize, në linjë edhe me vendime të mëparshme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kërkesa për rishikim, objekt shqyrtimi, nuk duhet të duhet të pranohet.
4. Pa përsëritur sa ka konstatuar Kolegji në vendime të mëparshme me objekt kërkimi të njëjtë¹ nga kërkues të tjerë, sipas një analizë harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
5. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsyetimit të mësipërm, sërish ato konstatohen se janë të njëjta me shkaqet e marra në shqyrtim deri tani në jurisprudencën e Kolegjit në raste² të ngjashme, dhe do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t’i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor. Në kushtet që vepra penale për të cilën është deklaruar fajtor ish gjyqtari L D referohet të jetë kryer vite përpara vendimit dhe nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, neni 494 germa “c” e Kodit të

¹ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024 që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit Artor Ylli.

² Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, dhe nr. 4, datë 15.02.2024.



Procedurës Civile nuk mund të argumentohet se gjen zbatim, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera³.

6. Për sa më lart, trupi gjykues, arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Artan Bajrami nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494 shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin. 498, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Artan Bajrami, për rishikimin e vendimit nr. 11 (JR), datë 03.07.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.02.2025.

REPubLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17-3/2021 regjistër (JR)
Datë 14.12.2022



Nr.10 i vendimit
Datë 28.02.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.02.2025, ditën e premte, në orën 11:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Griselda Muça, çështjen që i përket:

KËRKUES: Bilbil Mete, lindur në _____ dhe banues në rrugën “ _____”, Njësia Bashkiake nr. _____, Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe shfuqizimin e pikës nr. 2 të dispozitivit të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si të pabazuar në ligj e në prova.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 5, 35, 42, 48, 52, 122, 142, 148 e vijues, si dhe nenet F dhe G të Aneksit të saj;
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nenet 1, 6, 7, 13;

Kodi i Procedurës Civile, nenet 494 e vijues;

Kodi i Procedurave Administrative;

Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

Ligji nr. 7730, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 31 dhe 92;

Ligji 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, neni 57 e vijues;


Vendimi nr. 34, datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, vlerësoi mbi juridiksionin e Kolegjit për shqyrtimin e saj, por edhe konsideroi pretendimet e kërkuarit për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN NË MËNYRË TË PËRMBLEDHUR:

1. Kërkuari Bilbil Mete, (në vijim kërkuari), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), në zbatim të Nenit G të Aneksit të Kushtetutës, me vendimin nr. 322, datë 10.12.2020 vendosi ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e emërimit të z. Bilbil Mete, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare. Këtë vendim kërkuari e ankoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji"), i cili mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike shkaqet e ankimit të pretenduara nga z. Mete dhe me vendimin nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 322, datë 10.12.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Kërkuari Bilbil Mete, në kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021, të Kolegjit, parashtron në mënyrë të përmbledhur se:
 - 2.1 Vendimi i Komisionit si dhe vendimi i Kolegjit janë bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. , datë 15.10.2020. Nëpërmjet këtij vendimi, KLP ka disponuar "Për




mbarimin e statusit të magjistratit”, mbështetur në nenin 64, pika 1, germa “a” dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016, duke vendosur deklarin e mbarimit të statusit, për shkak të dorëheqjes të magjistratit Bilbil Mete nga detyra. Kundër këtij vendimi, kërkuar ka paraqitur kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin dhe plotësimin e dispozitivit të tij si vijon: “Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit Bilbil Mete, për shkak të daljes në pension pleqërie”. Gjykata e Apelit Administrativ, me vendimin nr. , datë 23.12.2020, vendosi rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi, kërkuar ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 362, datë 25.10.2022, ndër të tjera ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. , datë 13.12.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, pranimin e pjesës së padisë, ndryshimin e vendimit nr. , datë 15.10.2020 të KLP-së për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqje.

2.2 Kërkesa për rishikimin e vendimit të formës së prerë nr. 9 (JR), datë 23.03.2021 të Kolegjit, bazohet në nenin 494, germa “d” të Kodit të Procedurës Civile, e mbështetur në argumentin e kërkuar se, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. , datë 15.10.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për pjesën e motivacionit që lidhet me mbarimin e statusit të magjistratit për shkak dorëheqje, vendimi nr. 322, datë 10.12.2020 i Komisionit, si dhe vendimi nr. 9 (JR), datë 23.03.2021 i Kolegjit, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit, bëhen të cenueshëm.

3. Trupi gjykues në funksion të shqyrtimit të kërkesës me objekt rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mori fillimisht në analizë juridiksionin rishikues të Kolegjit në kuadër të procesit të rivlerësimit.
4. Referuar edhe jurisprudencës¹ së Kolegjit, sipas një analize harmonike dhe të gjithanshme të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore si dhe orientimeve të instrumenteve ndërkombëtarë, që kanë normuar procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
5. Gjithashtu, në kuadër të një vlerësimi garantist dhe shterues në drejtim të shmangies së çdo cenimi të mundshëm të ndonjë të drejte të kërkuar, trupi gjykues konsideroi edhe pretendimet e kërkuar, në kuptim të nenit 494, pika 1 germa “d” e Kodit të procedurës Civile, dhe

¹ Vendimi nr.12, datë 19.04.2024 që i përket kërkesave për rishikim të kërkuar Artor Ylli.



konkludoi se vendimi i Kolegjit, i cili kërkohet të rishikohet, nuk është mbështetur thelbësisht në vendimet e KLP-së apo Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, të cilat duket se janë ndryshuar prej vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 25.10.2022, por në analizën e vullnetit të subjektit për t'u dorëhequr nga detyra si kusht i aplikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, analizë e konsoliduar në një sërë vendimesh të marra nga Kolegji. Gjithashtu në këtë kontekst, në paragrafin 35, të vendimit që kërkohet të rishikohet, trupi gjykues sjell në vëmendje se vetë kërkuesi e ka paraparë procesin e tij në Kolegji si të pavarur dhe të pandikuar prej fatit që do të kishte rekursi i paraqitur prej tij në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, trupi gjykues nënvizon faktin se edhe nëse do të abstragohej nga mungesa e juridiksionit rishikues, kërkesa e kërkuesit për rishikimin e vendimit do të ishte njësoj e papranueshme.

6. Për sa më lart, trupi gjykues, arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Bilbil Mete nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494 germa "ë" e Kodit të Procedurës Civile, dhe as gjendet në kushtet e nenit 494, germa "d" e këtij Kodi, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenin. 498, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Bilbil Mete, për rishikimin e vendimit nr. 9 (JR), datë 23.03.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.02.2025.